

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
MINISTRISË SË INDUSTRIËS NDËRRMARRËSISË DHE TREGTISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR KRIJIMIN E NJË PLATFORME TË PËRBASHKËT DIGJITALE
TË INFORMACIONIT DHE PROMOVIMIT TURISTIK

Duke marrë në konsideratë interesin e përbashkët për zhvillimin e sektorit të turizmit në të dy vendet;

Mbështetur në Marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit në turizëm, nënshkruar nga qeveritë e të dy vendeve në Tiranë, më 06 Shkurt 2014;

Duke theksuar nevojën për forcimin, thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit në turizëm;

Me qëllimin e përbashkët për promovimin e potencialeve turistike të të dy vendeve;

Duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje;

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e promovimit digjital dhe aksesueshmërinë e lartë të platformave online,

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në vijim referuar si MTM, e Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Znj. Mirela Kumbaro Furxhi, Ministër, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 1, 1001, Tiranë dhe,

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si MINT, e Republikës së Kosovës,
përfaqësuar nga Znj. Rozeta Hajdari, Ministër, me adresë Lagjja e Spitalit, rr.“ Arbënor e Astrit
Dehari”, nr.21, Prishtinë

(së bashku, në vijim referuar si “Palët”),

Bien dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i një platforme digjitale për promovimin e përbashkët të të dy vendeve, si dhe të produkteve e paketave të përbashkëta turistike rajonale.
2. Kjo Marrëveshje ka për qëllim angazhimin e palëve për të bashkëpunuar në lidhje me promovimin e dy vendeve, si një destinacion i përbashkët turistik, i sigurt e mikpritës, me një ofertë turistike të konsoliduar dhe produkte autentike.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo Platformë e publikuar zbatohet në të dy vendet në faqet zyrtare promovuese të tyre, në menyrë që të informojë turistët dhe do t'i orientojë drejt destinacioneve dhe atraksioneve natyrore, vendet turistike dhe kulturore, ofruesve të shërbimeve turistike, produkteve ndërkufitare, etj., duke mbështetur zhvillimin dhe promovimin e ofertës së përbashkët turistike të të dy vendeve.

Neni 3

Detyrime të përbashkëta të Palëve

1. Palët janë kompetente dhe përgjegjëse për realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të përcaktuar në nenin 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi.
2. Palët do të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm, në përmbushje të qëllimit të kësaj Marrëveshjeje duke përfshirë dhe pa u kufizuar në:
 - a. njoftime dhe promovime që do të bëhen në kuadër të zbatimit të Platformës;
 - b. njoftime mbi kontribute të përbashkëta të palëve;
 - c. logo dhe emërtimet e palëve/institucioneve/subjekteve të përfshira në kuadër të Platformës.
3. Palët angazhohen të ndjekin realizimin e projektit dhe të zhvillojnë takime të përbashkëta në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, në Shqipëri dhe Kosovë. Rezultatet e takimeve dakordësohen mes Palëve dhe zbatimi i tyre monitorohet nga Palët në vijimësi.

4. Palët do të shkëmbejnë ekspertë në fushat e dakordësuara dhe shpenzimet do të mbulohen nga Pala dërguese.

Neni 4

Kontributi i palëve

Palët do të bashkëpunojnë brenda kuadrit kombëtar ligjor përkatës, për bashkimin e platformave digjitale informuese dhe ekzistuese të institucioneve respektive, në një platformë, duke e lënë të hapur mundësinë edhe për bashkimin në të, të platformave private në rast negociimi dhe dakordësie me këta të fundit.

Palët do të përpiqen për gjetjen e burimeve të financimit për përmirësimin, plotësimin, apo ridizenjimin e platformës promovuese, duke vënë palën tjetër në dijeni të kontributit respektiv.

Gjithashtu, në funksion të një platforme sa më të qëndrueshme të informacionit digjital të potencialeve turistike, kjo marrëveshje lë të hapur edhe mundësinë e parashikimeve në buxhetet vjetore të zakonshme të dy Ministrive, duke iu nënshtruar legjislacioneve të brendshme përkatëse. Në këtë rast masa e kontributit reciprok do të jetë pjesë e diskutimeve dhe dakordësisë paraprake mes dy palëve nënshkruese.

Neni 5

Monitorimi

Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, do të krijohet një grup i përbashkët pune mes dy vendeve, për realizimin konkret të bashkimit të platformave individuale ekzistuese, plotësimin e tyre me informacion të vijueshëm respektivisht të platformave individuale dhe monitorimin, për të garantuar zbatimin efikas të aktiviteteve të bashkëpunimit brenda kuadrit të Marrëveshjes. Përbërja e grupeve do të përcaktohet respektivisht nga secila palë.

Çdo Palë do të caktojë një Kryetar Grupi që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e fushave të bashkëpunimit, brenda 3 (tre) muajve pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Takimet do të zhvillohen çdo 6 muaj në mënyrë respektive në Shqipëri dhe Kosovë.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe ndryshimi

Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për Krijimin e një Platforme të Përbashkët Digjitale të Informacionit dhe Promovimit Turistik” do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët.

Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje do të jetë pesë vite nga data e hyrjes në fuqi.

Nëse gjashtë muaj para skadimit të afatit pesëvjeçar të marrëveshjes, asnjëra palë nuk paraqet ndonjë ankesë me shkrim për ndërprerjen e saj, kjo marrëveshje do të vazhdojë të jetë në fuqi edhe për pesë vitet e ardhshme.

Secila Palë ka të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në çdo kohë duke e njoftuar palën tjetër me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë brenda 3 (tre) muajve pas datës së marrjes së njoftimit.

Përfundimi i Marrëveshjes nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve për të cilat është rënë dakord në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe të iniciuara përpara përfundimit të saj, deri në përfundimin e tyre, përveç nëse Palët bien dakord ndryshe.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i marrëveshjes do të zgjidhet në mënyrë miqësore, përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta në rrugë diplomatike.

Neni 8

Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje do të hartohet dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale.

Nënshkruar në PRISHTINË, më 20.06.2022, në 2 (dy) kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Të gjitha tekstet janë njësoj autentike.

**Për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë
dhe Tregtisë të Republikës së Kosovës**



Znj. Rozeta Hajdari, Ministër

**Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të
Republikës së Shqipërisë**



Znj. Mirela Kumbaro Furxhi, Ministër